STRATEGJIA KOMBËTARE E TRANSPORTIT, OBJEKTIVAT NË AVIACION

Drejtori i Aviacionit Civil Krislen Keri, prezantoi prioritetet strategjike dhe objektivat...

faqe 2

AAC: TAKIM ME PRESIDENTIN E "BLUE PANORAMA"

Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil Krislen Keri, priti në një takim...

faqe 2

Korrik 2018 - Botimi III

posta ajrore

Buletini mujor i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar
www.aac.gov.al | info@acaa.gov.al
Tel: +355 4 22 51 220

BRUKSEL
QERSHOR 2018

AAC TAKIM NË KOMISIONIN E PËRKOHSHËM NË EUROCONTROL

faqe 3

STATISTIKA

RRITET NUMRI I PASAGJERËVE PËR MUAJIN MAJ

Referuar të dhënave zyrtare të Autoritetit të Aviacionit Civil në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza" në muajin Maj 2018 regjistrohet një fluks në rritje po ta krahasojmë...

TË REJAT E FUNDIT

AAC ZHVILLOI AUDITIN NDJEKËS NË ALBCONTROL

Rritja e niveleve dhe standarteve të sigurisë së shërbimeve të lundrimit ajror është prioriteti kryesor i gjithë aktivitetit të Autoritetit Kombëtar Mbikqyrës, në aviacionin civil shqiptar...

TË DREJTAT E PASAGJERIT, 140 KOMPENSIME NË 6 MUAJT E PARË TË 2018

faqe 4

STRATEGJIA KOMBËTARE E TRANSPORTIT, OBJEKTIVAT NË AVIACION

Në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Transportit 2018-2021, Drejtori i Aviacionit Civil Krislen Keri prezantoi prioritetet strategjike dhe objektivat në aviacion. Keri tha se ndër prioritetet strategjike për aviacionin shqiptar, renditen ndërtimi i Aeroportit të Vlorës dhe vënia në funksionim e Aeroportit të Kukësit. Duke u ndalur te Aeroporti i Vlorës, Keri tha se ky është një projekt që do të kërkojë rreth 24 muaj kohë të përfundojë nga data e fillimit të punimeve dhe pritet që ti sjellë një zhvillim të jashtëzakonshëm turistik zonës së Vlorës por edhe turizmit në vend. Një tjetër objektiv është vënia në funksionim e aeroportit të Kukësit, me një kapacitet deri në 1 milion pasagjerë dhe me impakt të madh për vendin por me ndikim edhe në Kosovë, pasi projeksionet janë që ky aeroport të jetë i kategorisë ultra low cost. Industria e aviacionit merr një rëndësi të jashtëzakonshme në kohët e sotme, pasi rreth 80% e turistëve në Botë zgjedhin transportin ajror, duke sjellë ndikim tejet të lartë jo vetëm për turizmin por edhe në ekonomi.Në afatshkurtër gjithashtu parashikohet një rritje e fluturimeve në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", si e linjave të reja dhe shtimi i fluturimeve charter. Ndërsa projeksionet për sezonin e pikut janë deri në 35-36 fluturime në ditë.

Në foto:
Drejtori i AAC z. Krislen Keri gjatë prezantimit

TIRANË: TAKIM ME PRESIDENTIN E "BLUE PANORAMA"

Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil Krislen Keri, priti në një takim z. Guido Patane, presidentin e kompanisë ajrore italiane "Blue Panorama", e cila zotëron rreth 20% të tregut të transportit ajror me destinacion Italinë. Drejtori komercial i kompanisë e prezantoi zotin Keri me planet e zgjerimit të kompanisë, që prej blerjes nga "UVET Group", një kompani e specializuar në sektorin e turizmit. Nga ana e tij Presidenti Patane, informoi zotin Keri se kompania është duke vlerësuar mundësinë për të investuar në sektorin e turizmit në Shqipëri. Drejtori i AAC Keri duke u ndalur te performanca e kësaj kompanie dhe partnerit shqiptar "Albawings", kërkoi që të shikohet mundësia për shtimin e destinacioneve të reja jo vetëm drejt Italisë, por edhe në destinacione të tjera europiane. Një aspekt i rëndësishëm ku z. Keri vuri theksin ishin të drejtat e pasagjerit ku torelanca do të jetë zero, me çdo lloj problematike dhe shkelje. Ai gjithashtu i kërkoi kompanisë që të marrë masat e duhura për të mos krijuar probleme për pasagjerët gjatë sezonit të pikut. Përfaqësuesit e informuan drejtorin e AAC, se kompania do të sjellë një avion rezervë për çdo lloj eventualiteti në Rinas, për të ofruar shërbim cilësor dhe pa vonesa ndaj pasagjerëve.

Në foto:
gjatë takimit në zyrat e AAC me përfaqësuesit e Blue Panorama

AAC: TAKIM NË KOMISIONIN E PËRKOHSHËM NË EUROCONTROL

Nëpërmjet Autoritetit të Aviacionit Civil, Shqipëria është anëtare aktive e Eurocontrol që nga viti 2002. Bashkëpunimi ynë shkon nga marrjet aktive nëpër takimet për menaxhimin e kësaj organizate ndërkombëtare siç janë takimet e Komisioneve të ndryshme si p.sh. ai i Përkohshëm dhe i Përheshëm, deri tek bashkëpunimet në nivel teknik-profesional për zhvillimin e aspekteve rregullative dhe rritjen e kapaciteteve profesionale në AAC. Më 21 Qershor 2018 në Eurocontrol u zhvillua takimi i Komisionit të Përkohshëm (PC), ku AAC u përfaqesua nga z. Arben Sula Drejtori i ANS dhe znj. Denisa Osmani përfaqësuesja pranë Eurocontrol. Në këtë takim, i cili përkonte edhe me emërimin e ri të Drejtorit të Përgjithshem të Eurocontrol z. Eamo Brennan, u trajtuan një sërë çështjesh me interes të Organizates së Eurocontrol dhe vendeve Europiane gjithashtu. Gjatë takimit u diskutua për vonesat në gjithë kontinentin Europian. Në vitin 2017, vonesat mesatare arritën 0.88 minuta në të gjithë rrjetin europian, që ishte 0.38 minuta më lart se objektivi i performancës prej 0.5 minuta. Në 2018, vonesat pritet të arrijnë mesatarisht në 1 minutë, që është dyfishi i objektivit europian. Nëse gjërat nuk ndryshojnë, deri në 2030 vonesat mund të arrijnë më shumë se në 6 minuta.

Një parashikim i fluturimeve është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:

Së dyti, Eurocontrol ka nevojë të modernizohet dhe planifikojë për të ardhmen. Eurocontrol duhet t'i japë përparësi aktiviteteve në mënyrë që të sigurojë që ajo të mbështesi industrinë e aviacionit europian në të ardhmen. Së treti, Eurocontrol është një organ neutral-multishtetëror, civilo-ushtarak, i cili mund të trajtojë sfidën e kapacitetit të përmendur më lart përmes një rrjeti të menaxhimit, në bashkëpunim të plotë me organizata të tjera si Komisioni Europian, ICAO, ECAC, etj.

Një nga spektret e rëndësishme me Eurocontrol është bashkëpunimi bilateral me AAC. Eurocontrol ka qenë mbështetës i vazhdueshëm i AAC-së dhe bashkëpunimi ynë shkon në disa fusha, që nga pjesëmarrja e AAC-së në Eurocontrol nëpërmjet një përfaqësuesi, deri tek marrëveshja speciale që kemi për të mbështetur dhe asistuar AAC-në, në aspekte rregullative dhe rritjen e kapaciteteve dhe ekspertizës në institucion.

Në foto:
Pamje e trafikut ajror në kontinentin europian

Aktualisht janë planifikuar dhe po zbatohen trajnimet dhe aktivitetet e mëposhtme:

	Aktivitete në bashkëpunim me Eurocontrol	Koha e kryerjes
1	Trajnime/Seminar për zhvillimin e skemës së performancës në Shqipëri SPPAT	Shtator-Tetor 2018
2	Trajnime të kombinuara për rregullat e konsoliduara Europiane të ajrit SERA/FUA	Shtator 2018
3	Dy misione afatgjata në Eurontrol, me përfaqësues nga Albcontrol dhe Forcat Ajrore për të zhvilluar procedurat e përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore në Shqipëri.	Qershor-Korrik 2018

EUROCONTROL

RAPORTI I PERFORMANCËS

Në raportin e Performancës për muajin Qershor vihet re një përmirësim i dukshëm i respektimit të orareve të nisjeve nga kompanitë ajrore. Në krahasim me muajt e mëparshëm të këtij viti, numri i fluturimeve të anulluara apo me vonesë ka rënë ndjeshëm, ndërsa një pjesë e madhe e problemeve që janë shënuar në muajin Qershor, lidhen kryesisht me problemet e motit apo me grevat në Itali. Vonesat dhe anullimet në përqindje më të madhe regjistrohen me Italinë. Në muajin Maj regjistrohen 8 anullime fluturimi ndërsa në Qershor shifra shkon në vetëm 3, si pasojë e motit të keq.

Në tabelën në të djathtë paraqiten edhe numrat e saktë me vonesa dhe anullime të fluturimeve gjatë muajit Qershor.

KOMPANIA	ANULLIME	VONESA MBI 2 ORË
BLUE PANORAMA *	1	7
ERNEST SPA **	1	1
ALITALIA	1	-
LUFTHANSA	-	3
ALBAWINGS **	-	2
AIR ALANNA ***	-	2
BRAVO AIRWAYS	-	1
AUSTRIAN AIRWAYS ****	-	1
NORWEGIAN AIR SHUFFLE *****	-	1
AIR SERBIA	-	-
VOLOTEA	-	-
BRITISH AIRWAYS	-	-
AEGEAN	-	-
TURKISH AIRLINES	-	-

Tabela përkatëse

SHËNIME

* 4 PËR SHKAK TË GREVËS , 3 VONESA OPERACIONALE DHE 1 ANULLIM SI PASOJË E PROBLEMEVE TEKNIKE
** PËR SHKAK TË GREVËS
*** VONESA PËR ARSYE OPERACIONALE
**** PËR SHKAK TË MOTIT TË KEQ
**** PËR SHKAK SE NUK KISHIN APLIKUAR PËR LEJE

TË DREJTAT E PASAGJERIT

Që nga fillimi i fushatës për mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve nga Autoriteti i Aviacionit Civil në muajin Dhjetor 2017, ka patur një rritje të ndjeshme të numrit të kompensimeve që kompanitë u kanë bërë pasagjerëve, për shkak të vonesave apo anullimeve të fluturimeve që nisen nga Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza". Nga shifrat zyrtare numri i pasagjerëve të kompensuar vetëm në muajin Qershor 2018 shkon në 60, ndërsa në total që nga muaji Dhjetor kap shifrën e 140 pasagjerëve. AAC-ja pret që kjo shifër të rritet akoma edhe më shumë pasi një numër i madh formularësh ankimimi janë në proces vlerësimi.

KOMPENSIME

Në vitet e mëparshme kompensimet ishin në shifrat 0. Ndërsa në muajin Maj ishin 80, në Qershor 60, në total numru shkon në 140 kompensime.

ANALIZA STATISTIKORE PËR MUAJIN MAJ 2018

MAJ 2018: Referuar të dhënave zyrtare të ardhura në Autoritetin e Aviacionit Civil, muaji Maj 2018 karakterizohet nga një fluks në rritje i pasagjerëve që udhëtojnë nëpërmjet transportit ajror. Shifrat referojnë një numër prej 220,117 pasagjerë të cilët kanë udhëtuar gjatë kësaj periudhe (9669 pasagjerë kanë udhëtuar me linja çarter).

PËRQINDJET: Referuar të dhënave të mësipërme, kompania ajrore "Blue Panorama" është mbizotëruese në treg duke mbuluar fluksin më të madh të lëvizjes së pasagjerëve për muajin Maj 2018, me një numër prej 43,129 pasagjerë ose 20% të totalit. Ndjekur nga "AlbaWings" me një numër prej 28,376 pasagjerë ose 13% ndaj Totalit, "Ernest s.p.a" me 23,857 pasagjerë ose 11% të Totalit dhe Alitalia 21,844 pasagjerë ose 10% të totalit mujor. Nisur nga këto të dhëna Italia vazhdon të zotërojë përqindjen më të madhe të tregut të transportit ajror për muajin Maj 2018, duke zënë 54% të totalit, ndjekur nga Turqia me 10%. Nëse referuar shifrave do të analizonim ecurinë e tregut të transportit ajror në vendin tonë për muajin Maj të viteve 2016-2017-2018, vëmë re, se kemi një rritje të numrit të pasagjerëve që udhëtojnë nëpërmjet ajrit, vit pas viti.

ÇARTER: Për sa i përket numrit të pasagjerëve të fluturimeve çarter për muajin Maj 2018 ka patur trefishim të fluturimeve, që në përqindje shkon në 204.92%, kjo si rredhojë e numrit të lartë të turistëve të huaj që kanë zgjedhur të vizitojnë vendin tonë.

Grafiku 1 :
Lëvizja e pasagjerëve që kanë udhëtuar për /nga TIA gjatë muajit Maj 2018, sipas kompanive ajrore.

NUMRI I PASAGJERËVE

MAJ 2018: Krahasuar me muajin Maj 2017, ka një rritje që në shifra konkrete shkon në 27,179 pasagjerë më shumë.

Po ta krahasojmë me muajin Maj 2016 diferenca është 58,100 më shumë pasagjerë në 2018.

Grafiku 3:
Numri i pasagjerëve për muajin Maj përgjatë 3 viteve të fundit

Grafiku 2:
Numri i pasagjerëve sipas kompanive për muajin Maj përgjatë 3 viteve të fundit

AAC ZHVILLON AUDITIN NDJEKËS NË ALBCONTROL GJATË MUAJIT QERSHOR

Ritja e niveleve dhe standarteve të sigurisë së shërbimeve të lundrimit ajror është prioritet i aktivitetit të Autoritetit Kombëtar Mbikqyrës, në aviacionin civil shqiptar. Bazuar në udhëzimin Nr. 118, datë 23.10.2012, të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, " *Për Miratimin e Rregullores për Mbikëqyrjen e Sigurisë në Menaxhimin e Trafikut Ajror dhe në Shërbimet e Lundrimit Ajror*" , një nga funksionet kryesore të Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC), nëpërmjet Drejtorisë së Mbikëqyrjes të Shërbimeve të Navigimit Ajror, është kryerja e funksionit të mbikëqyrjes sipas standarteve më të larta nga ekspertët përkatës të drejtorisë në mënyrë të tillë, që cilësia dhe siguria e ofrimit të shërbimit nga Albcontrol sh.a. të jetë sa më e lartë. Për këtë qëllim, AAC përgatit në mënyrë të detajuar një program auditimi dhe inspektimesh dy-vjeçare ku në qënder të këtyre aktiviteteve janë verifikimi i përpuethshmërisë dhe implementimit të rregulloreve, kërkesave rregullatore kombëtare dhe ndërkombëtare si edhe udhëzimeve dhe urdhëresave përkatëse të nxjerra nga Këshilli i Ministrave, Ministri i Transportit, nga Drejtori Ekzekutiv i AAC, nga ofruesi i shërbimeve të Lundrimit Ajror. Programi dy-vjeçar është përgatitur mbi teknikën e

risk-based oversight, duke marrë në konsideratë ngjarjet e ndodhura, rëndësinë e tyre dhe frekuencën e ndodhive. Ndryshimet e bëra dhe impakti që kanë patur në fushën operacionale dhe atë teknike në gjithë gamën e navigimit ajror. Në trajtimin e gjetjeve të European Aviation Safety Agency, (EASA) dhe gjetjet e Departamentit të ANS. Auditi ndjekës i radhës në ofruesin e shërbimeve Navigacionale Albcontrol, u krye nga AKM në Maj të 2018.

Me konkretisht, gjatë auditit ndjekës u verifikuan funksionet dhe shërbimet në fushën e:
(a) Kontrollit të Trafikut Ajror
(b) Informacionit Aeronautik
(c) Shërbimet Meteorologjike dhe ato të Komunikimit, navigimit dhe mbikëqyrjes me radarë
Në vijim u verifikuan përmbushja e kërkesave të licencimit të Kontrolloreve ajrore, funksionet e sigurisë (Safety) dhe ndjekja e rekomandimeve dhe gjetjeve të mëparshme si dhe verifikimi i UNC-ve. Si konkluzion i auditit në Maj 2018 rezultoi se Albcontrol ofron shërbimet e Trafikut Ajror në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Transporteve Nr. 83, datë 01.08.2012 *"Për miratimin e rregullores mbi rregullat e ajrit" dhe Udhëzimi i Ministrit të Transporteve* Nr. 80, dt. 31.07.2012 *"Për miratimin e rregullores për shërbimet e trafikut ajror"*. Shërbimet e MTA-së synojnë të mundësojnë operatorët e avionëve të realizojnë oraret e tyre të planifikuara të nisjes dhe mbërritjes, si dhe të qëndrojnë në profilin e tyre të preferuar të fluturimit me minimumin e devijimeve, pa kompromentuar nivelet e përcaktuara të sigurisë në operim. Safety gjithashtu ishte nga pikat e forta në Albcontrol gjatë verifikimit në auditin ndjekës të specialistëve të AAC. Vëmendje gjithashtu iu kushtua procesit të licensimit të Kontrollorëve të Trafikut Ajror që kryhet në përputhje me Urdhrin e Ministrit Nr. 117, datë 23.10.2012, *"Për Miratimin e Rregullores mbi Rregullat e Detajuara për Licensat dhe Certifikatat e Kontrolloreve të Trafikut Ajror"*. Aktualisht ka 83 Kontrollor të Trafikut Ajror, ndërsa për muajin Qershor 2018 janë validuar 46 Licensa të Kontrollorëve ajrorë.

Në foto:
stafi i AAC gjatë aktivitetit

AKTIVITETE TË DREJTORIVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL GJATË MUAJIT QERSHOR

Drejtoria e Mbikqyrjes së Operatorëve Ajror dhe Organizatave të Mirëmbajtjes ka miratuar së fundmi me anë të Vendimit të Drejtorit Ekzekutiv Nr.8 datë 25.06.2018, manualin udhëzues "Për Licencimin dhe certifikimin fillestar të operatorit ajror, regjistrimi i avionit, certifikimi i tij dhe miratimi i organizatave të përdoruesve". Ky material udhëzues përshkruan proçesin e aplikimit për marrjen e një Licence të Operatorit Ajror (LOA), regjistrimin dhe certifikimin e avionëve,

Licencën e Radios, Certifikatën e Zhurmës, Certifikatën e Operatorit Ajror (COA), si dhe miratimin e Organizatës për Vazhdueshmërinë e Vlefshmërise Ajrore apo Organizatës së Mirëmbajtjes, për të kryer operime të transportit ajror tregtar sipas Urdhrit të Ministrit nr. 151, datë 09.04.2014, të ndryshuar (që transpozon Rregulloren e BE-së Nr. 965/2012, të ndryshuar). Ky material jep informacion bazë të zbatueshëm për procesin e regjistrimit dhe certifikimit.

Drejtoria e Mbikqyrjes së Operatorëve Ajror dhe Organizatave të Mirëmbajtjes ka kryer 32 inspektime SAFA të avionëve të huaj që ulen në territorin e Republikës së Shqipërisë përgjatë vitit 2018. Në fokusin e këtyre inspektimeve janë avionët e linjave të rregullta që fluturojnë në Shqipëri si dhe avionët Charter, avionët privat etj, të cilët i ushtrohen kontrolleve të dokumentave të tyre dhe kontrolleve fizike. Këto inspektime kryhen në kuadër të rregullave ndërkombëtare për rritjen e sigurisë së fluturimeve në aviacionin civil, dhe kryhen nga inspektorët e kualifikuar të Drejtorisë së Mbikqyrjes të Operatorëve Ajror dhe Organizatave të Mirëmbajtjes.

Drejtoria e Sigurisë në Aviacion ka marrë pjesë në disa konferenca të ndryshme në lidhje me ICAO. Konkretisht në datat 28-31 Maj 2018 u mbajt "Konferenca Rajonale e Zyrës së ICAO-s për Evropën dhe Atlantikun e Veriut" me temë "Adresimin e sfidave të përbashkëta për zbatimin e Planit Global të Sigurisë së Aviacionit dhe miratimin e Udhërrëfyesit."
Pesë çështjet që u spikatën në këtë konferencë ishin:
1. Rritja e ndërgjegjësimit për rrezikun.
2. Zhvillimi i kulturës së sigurisë në Sigurinë e Aviacionit.
3. Përmirësimi i burimeve teknologjike dhe nxitja e inovacionit.
4. Përmirësimi i mbikqyrjes dhe i kontrollit të cilësisë.
5. Rritja e bashkëpunimit rajonal dhe e mbështetjes.
Nëpërmjet kësaj Konference njohja e Udhërrëfyesit të EUR/NAT për Sigurinë e Aviacionit është një dokument i "gjallë" që kontribuon në implementimin efektiv të GASeP-it nga shtetet dhe aksionerët e tjerë të rajoneve të EUR/NAT.

ICAO

Koordinatori Kombëtar i ICAO-s mori pjesë në mbledhjen e 8-të, të Koordinatorëve Kombëtarë Europian të Monitorimit të Vazhdueshëm që u mbajt më datë 8 Qershor në Këln të Gjermanisë. Kjo mbledhje u prezantua nga përfaqësues të ndryshëm të ICAO-s, si z. Nicollas Rallo i cili foli për zhvillimet e fundit në lidhje me programin e USOAP-it. Ai vuri në dukje që krahas objektivave të përmbushura nga ICAO gjatë vitit 2017, me interes ishte kalendari i aktiviteteve monitoruese. Ndërsa z. Arkadi Merkulov ICAO Regional Officer Safety, prezantoi zhvillimet e ICAO-s në aspektin rajonal duke përmendur arritjet në bashkëpunim me EASA-n.

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Aviacioni në Botë

HAMBURG DEFEKTI SHKAKTON KAOS NË AEROPORT

Një defekt në linjën kryesore të energjisë elektrike, ka shkaktuar panik në aeroportin e Hamburgut në Gjermani, që konsiderohet edhe si aeroporti më i ngarkuar. Mungesa e energjisë elektrike, shkaktoi evakuimin e 2 terminaleve dhe krijoi probleme të mëdha me anullime ose shtyrje fluturimesh. Për disa orë mungesa e energjisë krijoi panik në aeroport, ku 2 terminalet kryesore u zhytën në errësirë. Policia ndërhyri menjëherë duke bllokuar gjithë hyrjet në aeroport. Fillimisht autoritetet e Aeroportit nuk dhanë asnjë lloj shpjegimi, por

më vonë sqaruan se bëhej fjalë për një problem në linjën kryesore. Për të normalizuar situatën e krijuar u nevojitën 2 ditë. Aeroporti i Hamburgut regjistron një fluks të madh pasagjerësh, me një mesatare prej 17 milion në vit.

"ST.LOUIS" AEROPORTI DO JEPET ME KONCESION

Autoritetet e Aeroportit të "St. Luis" në shtetin e Missourit në SHBA, kanë kontraktuar një kompani, e cila do të përcaktojë nëse ky aeroport duhet të jepet me koncesion apo do të menaxhohet nga autoritetet. Mbështetësit e kësaj ideje, thonë se privatizimi do të kthejë këtë aeroport në pikë të rëndësishme që mund të gjenerojë edhe të ardhura. Ndërsa kritikët thonë se ka mungesë transparence dhe nuk i shërben publikut. Për të sqaruar këtë situatë ishte kryetarja e Bashkisë Lyda Kreuson, e cila theksoi se ky proces mund të mbyllet shumë shpejt, por edhe mund të zgjasë deri në 3 vite. Ajo qetësoi zërat kundër duke thënë se do të merren pasasysh gjithë sugjerimet dhe zëri i gjithë qytetarëve.

GATI SKANERI FYTYRËS NË AEROPORTIN E ORLANDOS

Aeroporti i Orlandos është i pari që ka gati futjen në përdorim të teknologjisë së skanimit të fytyrës, për pasagjerët e huaj që vijnë nga aeroportet e Anglisë. Në testet që kanë filluar tanimë në këtë aeroport të rëndësishëm amerikan, pasagjerëve u duheshin vetëm 10 sekonda për të kaluar te skaneri, duke reduktuar në maksimum kohën e pritjes dhe evitimin e radhëve të gjata. Testimet kanë filluar që nga muaji Prill, dhe kanë ecur mjaft mirë, duke bërë që autoritetet të jenë optimist për futjen në përdorim 100% brenda vitit. Kjo teknologji kap vlerën e 4 milion dollarëve dhe skanon çdo person që kalon në gatet ndërkombëtare. Funksionimi është shumë i thjeshtë, pajisjet që skanojnë fytyrat lidhen direkt me databazën e autoriteteve federale. Testimi i kësaj teknologjie ka filluar edhe në disa aeroporte të tjera, duke reduktuar ndjeshëm orarin e pritjes, veçanërisht në periudhat e pikut. Megjithatë ekspertët thonë se teknologjia nuk është e mjaftueshme për 100% siguri.

IATA: SHEFI EKZEKUTIV I QATAR AIRWAYS ZGJIDHET KREU I BORDIT

Shefi ekzekutiv i kompanisë së njohur Qatar Airways është zgjedhur drejtori i bordit të guvernatorëve të IATA (Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror). Në takimin e mbajtur në Sidney të Australisë, Akbar Al Baker, u zgjodh në këtë

pozicion duke u bërë drejtori i 77-të i bordit të IATA që nga krijimi i saj. Mandati i tij do të jetë 1-vjeçar. Al Baker njihet si një nga personat kryesor që e ktheu kompaninë Qatar Airways nga një kompani lokale në globale.

TEKNOLOGJIA NË AVIACION

Transformimet e thella dixhitale në Botë, kanë sjellë domosdoshmëri për futjen e këtyre teknologjive edhe në Aeroportet e ndryshme. Në kontinentin Europian vëmendje i kushtohet paralelisht investimit në teknologji dhe në infrastrukturë por jo në inovacion. Sipas studimeve aeroportet e kontinentit Aziatik i kushtojnë rëndësi të madhe inovacionit. Vëmendja kryesore është në investimet me aspektet teknologjike, që lidhen me të ashtëquajturën teknologji biometrike, e cila kryen kontrollin kufitar dhe reduktimin e kohës së pritjes. Kjo teknologji është duke u aplikuar në këtë periudhë, dhe pritet që brenda një kohe të shkurtër të jetë në çdo aeroport. Por do të shoqërohet me ligje dhe masa të forta që lidhen me aspekte të privatësisë. Inteligjenca Artificiale është një tjetër element që pritet të jetë dominant dhe në qëndër të zhvillimeve të ardhshme në aviacion. Kompania "Emirates" ka në plan që brenda një kohe të shkurtër të fusë në përdorim robotët, në ndarjen e bagazheve për të eliminuar tërësisht faktorin njerëzor në këtë proces.